REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
KËSHILLI I PËRMBARIMIT

Nr 5502/4 Prot. Tiranë, më 09.11.2026

VENDIM

Nr. 47 datë 09.11.2026

"PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR SHPREHJE INTERESI PËR PËRMBARUES GJYQËSOR SHETËROR"

Këshilli i Përmbarimit në mbështetje të Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 167, datë 25.03.2024, *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Përmbarimit";* Urdhrit nr. 432, datë 30.6.2023, *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit si dhe procedurën e vlerësimit të shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror"*, i ndryshuar me Urdhërin nr.319 datë 10.06.2024, të Ministrit të Drejtësisë; Urdhrit nr. 502 datë 27.10.2026, *"Për caktimin e antërëve dhe formësimin e Këshillit të Përmbarimit";* Urdhrit nr. 510, datë 30.10.2026, *"Për fillimin e procedurave për shpalljen e* 12 *(dymbëdhjetë) vendeve vakante për përmbarues gjyqësor pranë Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror"*, të Ministrit të Drejtësisë si dhe procesverbalit të datës 09.11.2026,

VENDOSI

1. Miratimin në datë **22.12.2026, ora 10 ^{00}**, për zhvillimin e provimit të pranimit për përmbarues gjyqësor shtetëror, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, në adresën: Bulevardi "Zogu i Parë", Tiranë;
2. Të publikojë Vendimin në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe Ministrisë së Drejtësisë;
3. Miratimin e thirrjes për shprehjen e interesit për hyrjen në provimin e pranimit dhe të publikimin e thirrjes në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe Ministrisë së Drejtësisë;
4. Miratimin për datën 17.11.2026 ora 16:30, si afatin përfundimtar për depozitimin e dokumentacionit sipas kërkesës për shprehje interesi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I PËRMBARIMIT